



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e73-të, të mbajtur më 18.08.2022, morri vendimin vijues:

### VENDIM

Procedura në lëndën me numër 12-1977 të vitit 2021, e formuar pas denoncimit të dorëzuar për personin zyrtar, drejtor dhe persona të punësuar -----, NDËRPRITET.

KSHPK-ja nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm, ndërsa lënda do të dorëzohet në veprim kompetent te organi tjetër gjegjësisht në Prokurorinë Themelore Publike-----.

Lënda me numër 12-1977 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

### Arsyetim

Nga një parashtrues i panjohur, përkatësisht grup i të punësuarave në NP----- më datë 20.05.2021, është dorëzuar denoncim për personat zyrtarë përgjegjës në NP-----, dhe është formuar lënda me numër 12-1977 të vitit 2021.

Pretendimet në denoncim kanë të bëjnë me dyshime për shkelje të disa ligjeve në periudhën e vitit 2018, kur është kryer pagesa e më shumë se një rroge për një muaj për një punonjës në NP -----, konkretisht për personin -----, dhe gjithashtu është kryer rritja e pagave të disa punonjësve në ndërmarrjen publike të përmendur.

Këto pagesa janë kryer pa vendim të Bordit Drejtues të kompanisë, në kohën kur kompania operonte me humbje.

Gjithashtu në denoncim thuhet se këto pagesa janë bërë të mundura me miratimin e kryetarit të komunës ----- aktuale në periudhën e përmendur, -----, për arsye se Ndërmarrja Publike ----- është në kompetencë të Komunës -----.

Meqenëse në denoncim thuhet se ky tekst është dorëzuar edhe në Prokurorinë Themelore Publike në -----, KSHPK-ja ka drejtuar me Kërkesë për dorëzimin e të dhënave dhe informatave lidhur me pretendimet e tilla, pra informacione nëse PTHP – ----- ka krijuar tashmë një rast në lidhje me pretendimet nga denoncimi.

Prokuroria Themelore Publike ----- ka dorëzuar përgjigje në kërkesën e parashtruar në të cilën thuhet se në lidhje me kompaninë e përmendur është themeluar rast me kodin nr.---- --/ 18, dhe pas kallëzimit penal nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Lidhjeve -----, kundër ----- nga ----- drejtor i NP -----, në periudhën 2009-2017, lidhur me raportin e auditimit për auditimin e kryer të operacioneve materiale dhe financiare si dhe për rregullsinë e blerjeve të kryera në NP ----- në periudhën e vitit 2016, për të cilën procedurë është miratuar Aktvendim-Vendim për refuzimin e kallëzimit penal.

Nga dokumentacioni i pranuar është konstatuar gjendja faktike se pretendimet e paraqitura në kërkesë janë të ndryshme në lidhje me përmbajtjen e lëndës të trajtuar në procedurën e udhëhequr nga PTHP – -----.

Nga sa u tha më sipër, KSHPK-ja ka konstatuar se nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme, dhe lëndën do ta dërgojë për veprim kompetent në një organ tjetër kompetent, në rastin e Prokurorisë Themelore Publike ----- për arsye se pas konstatimit të gjendjes faktike, se për rastin konkret, veprimet e denoncuar do të duhet të trajtohen nga organi tjetër kompetent, dhe të vendoset si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti: Mr K.Z

Miratoi: NB, anëtar i KSHPK - së

KOMISIONI SHTETËRORE  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
Kryetare,  
Biljana Ivanovska